




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEKANI



**Kriteret e transferimeve dhe programeve të dyta të studimeve, në programet e studimeve të Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë, në FTI, viti akademik 2020-2021**

Kandidatët që aplikojnë për **transferim studimesh në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në FTI**, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

**I. Kriteret kualifikuese:**

- a. Të jetë duke ndjekur studimet Bachelor në programe studimi të njëjta apo të ngjashme me Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Inxhinieri Informatike që ofrohen në FTI.
- b. Kandidati duhet të ketë notë mesatare mbi 6.5, e llogaritur sipas VKM-së përkatëse për pranimet, për vitin akademik 2020-2021.
- c. Kandidati duhet të ketë fituar mbi 30 kredite në programin e studimit ku transferohet.
- d. Pikët e grumbulluara nga rezultatet e shkollës së mesme të kandidatit, të llogaritura sipas kriterit të përgjithshëm të pranimeve në FTI (formula e pranimit), duhet të jetë mbi pragun minimal që është arritur në vitin përkatës, në programin e studimit të kërkuar.


**II. Kriteret renditëse:**

- a. Renditja e kandidatëve do të kryhet në bazë të pikëve sipas formulës së pranimit në FTI, për vitin akademik 2020-2021.

Kandidatët që aplikojnë për **program të dytë studimi në programet e studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në FTI**, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEKANI



**I. Kriteret kualifikuese:**

- a. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi duhet të plotësojë kriterin e notës mesatare mbi 6.5, të llogaritur sipas VKM-së përkatëse për pranimet, për vitin akademik 2020-2021.

**II. Kriteret renditëse:**

- a. Renditja e kandidatëve do të kryhet në bazë të pikëve sipas formulës së pranimiit në FTI, për vitin akademik 2020-2021.

Kandidatët që aplikojnë për **transferim studimesh në programet e studimit të Ciklit të Dytë, Master Shkencor në FTI**, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

**I. Kriteret kualifikuese:**

- a. Të ketë diplomë Bachelor apo Diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë, të njëjtë apo të ngjashme me diplomat Bachelor në Inxhinieri Elektronike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UPT.
- b. Të jetë duke ndjekur një program studimi Master i Shkencave (të njëjtë ose të ngjashëm) brenda ose jashtë vendit, të akredituar në momentin transferimit;
- c. Të ketë marrë të gjitha kreditet e vitit të parë (60 kredite) në programin e studimit Master i Shkencave, nga ku do të transferohet.
- d. Kandidatët me diplome Bachelor të fituar jashtë FTI, përveç plotësimit të kriterëve më sipër, duhet të kenë mesataren e ponderuar të studimeve Bachelor jo më të vogël se shtatë ( $\geq 7.00$ );

**II. Kriteret renditëse:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIKI I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEKANI



- a. Së pari, renditen kandidatët sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacion ose Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UPT;
- b. Në rast se pas plotësimit të pikës (a), ka ende kuota të lira, renditen kandidatët me diplomë Bachelor të fituar jashtë FTI-së, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, e cila bazuar në kriteret kualifikuese më sipër (pika I/d) duhet të jetë më jo më e vogël se shtatë ( $\geq 7.00$ ).

Kandidatët që aplikojnë për **transferim studimesh në programet e studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional në FTI**, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

**I. Kriteret kualifikuese:**


- a. Të ketë diplomë Bachelor apo Diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë të njëjtë apo të ngjashme me diplomat Bachelor në Inxhinieri Elektronike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UPT;
- b. Të jetë duke ndjekur një program studimi Master Profesional (të njëjtë ose të ngjashëm) brenda ose jashtë vendit, të akredituar në momentin e transferimit;

**II. Kriteret renditëse:**

- a. Së pari, renditen kandidatët sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UPT;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEKANI



- b. Në rast se pas plotësimit të pikës (a), ka ende kuota të lira, renditen kandidatët me diplomë Bachelor të fituar jashtë FTI-së, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

Kandidatët që aplikojnë për **program të dytë studimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë, Master Shkencor dhe Master Profesional në FTI**, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

**I. Kriteret kualifikuese:**

- a. Të kenë përfunduar me sukses studimet dhe të jenë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të Ciklit të Parë Bachelor, apo në një program të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose të jenë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të Ciklit të Parë Bachelor, ose në një program të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë dhe të kenë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
- b. Kriteret renditëse:**
  - a. Kandidatët renditen sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.